



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. MS..datë 27.06.2019

PER SHPALLJEN E VENDEVE TE LIRA PER TE EMERUARIT

Në përputhje me nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 35/3 dhe 39/1 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

Neni 1

Të shpallë si vende të lira për emërimin e magistratëve të profilit prokuror, të diplomuar në vitin akademik 2017 – 2018, vendet e mëposhtëme:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat - 1 vend;
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër - 1 vend;
3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë - 2 vende;
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë - 1 vend;
5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë - 1 vend;
6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë - 1 vend;
7. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë - 1 vend;
8. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë - 1 vend;

Neni 2

Të ftojë magistratët e profilit prokuror të diplomuar në vitin akademik 2017 – 2018 të paraqesin një kërkesë me shkrim ku të tregojnë parapëlqimin e tyre për 3 (tre) prej vendeve të përmendura në nenin 1 të këtij Vendimi, sipas rradhës së parapëlqimit, jo më vonë se 2 javë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Gent Ibrahimi